

## **PROCESVERBAL**

### **Nga Kuvendi i Pestë i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, i mbajtur me 5 maj 2017 në Gjenevë**

**Prezent, anëtarët e kryesisë:** Ali Mehmeti, Fadil Avdija, Fadil Selmani, Nebi Hyseni, Afërdita Krasniqi, Nerxhivane Ferati, Lutfi Rexha, Blerim Ibrahim, Lulzim Sejdiu, Skënder Svarqa, Lah Jashari dhe Nasuf Nuhiu.

**Mungojnë, anëtarët e kryesisë:** Musah Halili dhe Nerxhivane Ferati

Po ashtu në sallë janë të pranishëm edhe rreth 40 persona tjerë, anëtarë të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës.

Mbledhjen hapi kryetari i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës (KShGj) z. Ali Mehmeti duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke propozuar rendin e ditës që u ishte dërguar anëtarëve të KShGj-së tre javë përpara me postë klasike dhe me postë elektronike:

#### **REND DITE**

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i katërt;**
- 2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi;**
- 3. Paraqitja e Bilancit financiar për vitin 2016 dhe paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtin vit, diskutimi dhe aprovimi;**
- 4. Ndryshimi i nenit 5 të Statutit të KShGj-së**
- 5. Zgjedhja e anëtarëve të kryesisë, plotësimi me anëtarë të rinj;**
- 6. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2017**
- 7. Përcaktimi i shoqatave të cilat kanë të drejtë të delegojnë nga një anëtar në kryesinë e KShGj-ës, sipas nenit 16, pika g) të Statutit tonë;**
- 8. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë;**
- 9. Të ndryshme**
- 10. Fjalë rasti nga të ftuarit**

Ky rend dite u aprovua njëzëri dhe u kalua në pikën e parë.

#### **1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i Katërt**

Procesverbali nga Kuvendi i Katërt i është dërguar të gjithë anëtarëve të KShGj-së paraprakisht ashtu që kanë pas mundësinë ta lexojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që PV u aprovua njëzëri.

#### **2. Paraqitja e Raportit të punës, diskutimi dhe aprovimi**

Kryetari i KShGj Ali Mehmeti, paraqiti raportin e punës që përfshin periudhën ndërmjet dy kuvendeve, respektivisht nga 18 maji 2016 gjer më 4 maj 2017. Të pranishmëve në sallë iu është paraqitur në ekran me video-projektor. Anëtarëve të komunitetit i u është dërguar paraprakisht me postë elektronike ashtu që kanë pasur mundësinë ta lexojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që Raporti i punës u aprovua njëzëri.

### **3. Paraqitja e raportit financiar, diskutimi dhe aprovimi**

a) Arkëtari, Nasuf Nuhiu, paraqiti Raportin financiar për vitin 2016. Anëtarëve të komunitetit i u është dërguar paraprakisht me postë ashtu që kanë pas mundësinë ta shikojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje dhe raporti u aprovua njëzëri.

b) Verifikuesit e kontos, të emëruar në Kuvendin e Katërt, Ismet Kurteshi, Rifat Haxhijaj dhe Ilir Sahiti, paraqitën raportin e tyre të shkruar dhe nënshkruar për vitin 2016. Ata konstatuan se raporti financiar është në përputhje me Statutin e shoqatës dhe ligjin, prandaj i propozuan Kuvendit ta aprovojnë. Raporti u aprovua njëzëri.

### **4. Ndryshimi i Nenit 5 të Statutit**

Neni 5 i Statutit të KShGj-së është ridefinuar në mënyrë që në të dy paragrafët fshihet fjala "jopolitike" dhe zëvendësohet me "jopartiake"

### **5. Zgjedhja dhe rizgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së KShGj-së dhe zgjedhja e kryetarit,**

Në krahasim me përbërjen e kaluar të kryesisë së KShGj disa nga anëtarët janë tërhequr për arsye të ndryshme (Lulzim Sejdiu, Nerxhivane Ferati dhe Musah Halili). Kurse në këtë kuvend është propozuar dhe pranuar Naser Islami sikur përfaqësues i shoqatës "VITIA". Pra, anëtarët aktual të kryesisë së KShGj-së janë:

1. Afërdita Krasniqi,
2. Ali Mehmeti,
3. Fadil Avdija,
4. Fadil Selmani,
5. Lah Jashari,
6. Lutfi Rexha,
7. Nasuf Nuhiu,
8. Nebi Hiseni,
9. Skender Svarqa
10. Blerim Ibrahim
11. Naser Islami

Kurse për kryetar të KShGj-së u zgjodh znj. Afërdita Krasniqi për një mandat dyvjeçar. Kryetarja e porsazgjedhur mori fjalën duke falënderuar për besimin e shprehur.

Sekretari dhe arkëtari do të zgjidhen nga vet kryesia në mbledhjen e parë.

### **6. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2017**

Për verifikues të kontos janë propozuar edhe nga publiku z. Ilir Sahiti, Ismet Kurteshi dhe Rifat Haxhija. Propozimi u aprovua njëzëri.

### **7. Përcaktimi i shoqatave të cilat e kanë të drejtën të delegojnë nga një anëtar në kryesinë e KShGj-së**

Nuk ka shoqata të reja për t'ia shtuar nga një anëtarë kryesisë së KShGj

### **8. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë,**

Edhe pse ka pasur diskutime dhe mendime të ndryshme, megjithatë u vendos me shumicë votash që anëtarësia të mbetet 100fr në vit për familje. Përjashtim bëjnë familjet që janë në asistencë sociale, personat në pension invalidor dhe studentët që janë në Gjenevë pa familje; anëtarësia për ata do të mbetet 20fr në vit.

## 9. Të ndryshme

Një person i pranishëm në sallë, që nuk është anëtar i KShGj, propozoi që të hiqet nga Statuti formulimi sipas të cilit "KShGj është shoqatë jofetare". Ky propozim u refuzua.

## 10. Fjalë rasti nga të ftuarit

Në kuvendin e sotshëm ishin të ftuar përfaqësuesit diplomatik të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ambasadori i Shqipërisë z. Ilir Gjoni është përgjigjur me shkrim duke kërkuar falje për mungesën e tij. I pranishëm ishte Konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Gjenevë z. Ramadan Avdiu i cili mori fjalën.

Ai së pari përshëndeti të pranishmit. Pastaj falënderoi Komunitetin Shqiptar të Gjenevës për punën e dobishme që po bën; sidomos në ruajtjen e kulturës së origjinës. Ai theksoi se konsullata është e hapur për çfarëdo ndihme që mund t'i ofroi komunitetit.

Procesmbajtës  
Fadil Avdiu

Kryetare  
Afërdita Krasniqi